



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.12.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

- Kërkesë për shtesë në objektin e komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”;
- Kërkesë për zgjatje të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Vasilika Hysi - Zëvendëskryetare e Kuvendit

Myslim Murizi - Zëvendëskryetar i Kuvendit

Elisa Spiropali – Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin

Taulant Balla - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Rudina Hajdari - Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat/Kryetare e Komisionit për Integrimin Europian

Nimet Musaj - Kryetar i Grupit Parlamentar të Pavarur

Ulsi Manja - Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mimi Kodheli - Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme

Arben Ahmetaj - Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave

Ermonela Felaj - Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare

Niko Peleshi – Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Enver Rroshi - Kryetare i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

Milva Ekonomi – Zëvendëskryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me këtë rend dite,

Kërkesën për shtesë në objektin e komisionit hetimor: "Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore". Është bërë një kërkesë nga një grup deputetësh për të shqyrtuar edhe një çështje tjetër mbi objektin e hetimit, si dhe një kërkesë nga komisioni hetimor për zgjatjen e afatit të veprimtarisë të komisionit.

Kërkesa e bërë bazohet në nenin 8, pika 3, të ligjit nr. 8891, datë 2.05.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore". Fjala është për dekretin e Presidentit për znj. Marsida Xhaferllari si anëtare e Gjykatës Kushtetuese dhe refuzimin për kryerjen e betimit të znj. Arta Vorpsi si anëtare e Gjykatës Kushtetuese. Këto duhet të bëhen pjesë e veprimtarisë së komisionit hetimor, sipas vlerësimit që kanë bërë nismëtarët e kërkesës. Kërkesa e paraqitur nga ana formale-procedurale përmban elementët e domosdoshëm, që kërkon neni 6 i ligjit për komisionet hetimore si dhe neni 112 i Rregullores së Kuvendit, konkretisht:

- Është paraqitur me shkrim si dhe përmban nënshkrimet përkatëse;
- I është adresuar Kryetarit të Kuvendit;
- Është paraqitur në mënyrë të motivuar për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë;
- Përmban nënshkrimet përkatëse të propozuesve (mbi 35 deputetë).

Njëkohësisht, me kërkesën e komisionit hetimor është kërkuar që ky komision të zgjasë veprimtarinë e vet edhe me 4 muaj të tjerë. Me të dyja kërkesat tashmë jeni njohur, pasi ju janë

vënë në dispozicion elektronikisht, gjithashtu i keni përpara në tavolinat e punës. Çfarë mendoni në lidhje me kërkesat e paraqitura?

Rudina Hajdari – Jemi në një kohë të vështirë dhe mendoj është e panevojshme për momentin. Deri diku jam dakord me zgjerimin e mandatit të komisionit hetimor, por kërkesa për zgjerimin dhe mënyrën e hetimit, thjesht do t'i nxiste konfliktet midis mazhorancës dhe Presidentit dhe nuk do të sillte asnjë rezultat. E kuptoj që rëndësia është padyshim ngritja e Gjykatës Kushtetuese, por nga ana tjetër mendoj që ne po nxisim një konflikt që është i panevojshëm për momentin dhe në frymën e solidaritetit por edhe të bashkëpunimit politik, mendoj që ne duhet të jemi pak më të kujdesshëm sot dhe të mos e nxitojmë këtë procedurë, sepse komisionet e hetimit aty janë. Gjykata Kushtetuese ka rëndësinë e saj, por mos e nxisim konfliktin e Presidentit. Duhet të kuptojmë zoti Kryetar i Kuvendit që në këto momente ne nuk duhet të fokusohemi te ky konflikt dhe duhet të respektojmë figurën e Presidentit të Shqipërisë dhe mos ja cenojmë figurën e tij për momentin sepse na duhet figura e tij në krye të vendit dhe na duhet që ne të kemi një bashkëpunim ndërinstitucional dhe të krijojmë një frymë të bashkëpunimi me njëri – tjetrin. Në këtë frymë do të kërkoja që ta rishikonim qoftë objektin e zgjerimit por edhe këtë konflikt pak më me imtësi dhe për të parë nëse mund të ketë ndonjë lloj mënyre tjetër për ta zgjidhur këtë konflikt, duke qenë se edhe Kryeministri edhe Presidenti janë takuar, nuk është se nuk janë takuar kohët e fundit. Pa dashur, edhe njëherë që ky konflikt të përshkallëzohet akoma më tej, në momentin që ne nuk kemi më nevojë do doja shumë që ta rishikonim këtë pikë edhe mos të përfshiheshim në seancën e sotme. Kjo është kërkesa ime.

Taulant Balla – Së pari, dua të sqaroj kolegët anëtarë të Konferencës së Kryetarëve që nuk bëhet fjalë për asnjë lloj konflikti qoftë personal apo qoftë institucional me Presidentin e Republikës. Personalisht, dua t'iu them që gjatë këtyre ditëve jam takuar me Presidentin e Republikës, në shumë zona të prekura rëndë nga tërmeti, kemi biseduar, kemi diskutuar. Nuk bëhet fjalë këtu për konflikt. Këtu bëhet fjalë për ushtrim të kompetencës të Kuvendit të Shqipërisë për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me shkelje të Kushtetutës dhe nënkryetari i komisionit hetimor zoti Zeneli, ka drejtuar dje apo pardje një mbledhje në bashkëpunim me dy anëtarë të tjerë, ka rënë dakord për ta shtuar afatin e komisionit hetimor për 4 muaj, ndërkohë që të mos harrojmë që Gjykata Kushtetuese dhe jurisprudenca kushtetuese është shumë e qartë në të drejtën e kërkuarve të një komisioni hetimor për objektin e hedhur. Pra, në praktikën e konsoliduar parlamentare janë nga viti 2002 që funksionojnë komisionet hetimore parlamentare, pasuruar me vendimet pasuese të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e kërkuarve për objektin e hetimit ka qenë qoftë kur unë kam qenë në opozitë 8 vite dhe qoftë kur kolegët e mi

të Partisë Demokratike kanë qenë në opozitë. Asnjëherë Kuvendi qoftë në Konferencën e Kryetarëve padyshim jo, edhe Kuvendi si i tërë nuk ka vënë limite në objektin e hetimit. Është e drejta e kërkuesve objektiviteti.

Për sa i përket vlerësimit të zonjës Hajdari për momentin, Kuvendi i Shqipërisë sot ka një paketë shumë të gjerë mbështetëse për familjet e prekura nga tërmeti dhe do të thosha që fokusi ynë të jetë atje. Vijimi i punës të angazhimit të përditshëm të Kuvendit në mbrojtje të Kushtetutës dhe të institucionalitetit në vend është pjesë ...dhe prandaj këtij komisioni i shtyhet afati. Kur të jemi në një moment më të qetë padyshim që do diskutojmë më gjerë e gjatë por edhe raportin përfundimtar të këtij komisioni, i cili në vlerësimin tim duhet të ketë dy pjesë, vlerësimin nëse është në shkelje të kushtetutës apo jo dhe rekomandimin për të shmangur raste të tilla të ngjashme në të ardhmen. Është e papranueshme që një institucion që ka për detyrë të bëjë betimin, të ushtrojë kompetencën për të ofruar betimin në mënyrë tjetër, anëtar i Gjykatës Kushtetuese nuk e jep këtë të drejtë, prandaj le t'ia lëmë hetimit dhe thelbi i komisionit hetimor për fat të mirë, jemi të përfaqësuar njëlloj edhe mazhoranca edhe opozita. Ne kemi Kryetarin e Komisionit, ju keni nënkryetarin.

Gramoz Ruçi – Ka ndonjë gjë tjetër?

Myslym Murrizi – Në historikun 29 vjeçar post komunizmit një vrimë në ujë kanë bërë komisionet hetimore në Parlament. Unë nuk kam pikë dyshimi, që të njëjtën linjë, të njëjtin rrugë dhe të njëjtin fat do të kenë edhe letrat e këtij komisioni. Ajo që shikoj me skepticizëm është që populli thotë: “Kur gjëmojnë topat nuk gjëmojnë pushkët”, besoj është më shumë lajm edhe ju e kuptoni nëse jeni më pak me përvojë ose më pak të ftilluar politikisht në të gjithë ata që marrin vesh nga politika. Është një lajm në këtë valë fatkeqësisht që i ndodhi vendit tonë në Durrës dhe Tiranë. Që e kemi mendjen gjithandej, krahas hallexhinjve, këtyre spektakleve të kohëve të fundit që kemi parë, mes kryetarit tuaj dhe ish kryetarit tim. I ndërrojnë shtëpitë me radhë një hyn një del, një shkon paradite, një shkon në 12:00 të drekës, gallatë. I pret biletat e fugonit, një rrok qen në qafë, 4 muaj. Çfarë do bëni, se u bë një vit? Nuk keni ndarë ende mendjen me veten. E hetoni apo nuk e hetoni dot? Çfarë mendoni ta dënojmë me varje Metën? E hiqni apo nuk e hiqni? Kjo është çështja. Sa takat keni, sa ju lënë ta çoni deri në fund? Pasi e morët me vrull dhe u ftoh gjatë rrugës. Unë ju thashë para 2 muajve që ju nuk do t'iu betojë ato prokurorët e SPAK-ut. Ju më thatë nuk betohet tek ai. Ku do betohen? Te noteri, foltorja, buza e lanës, ku? Jeni më korrekt me veten tuaj. Çfarë, keni ndarë mendjen? Ju keni shumicën. Do ta çoni deri në fund? Unë nuk shikoj fare atë që tha zonja Hajdari. Ai na përqafoi me të, u

takua në Vlorë. Ishte gëzuar shumë Nard Ndoka, që u takua Rama me Metën në Vlorë, që Rama shpërndau postimin e Bashës, që shpalli gjendjen e jashtëzakonshme se i tha Basha dhe i ka hapur krahun që të vijmë ne tani. Unë e shikoj që është një shoë kot, gjoja sikur ata janë bërë gati, sikur po i çoni radhën ju, bëhen 29 vjet që zihen 20 hajdutë. Një palë rrinë 8 vjet dhe ikin të ngopur, pastaj nga vitet e fundit i vjen uria prapë dhe këta që janë të tej ngopur thonë o burra të hapim krahun, meqë ra tërmeti...

Mu kujtua ajo historia e atij çunit të keq në shtëpi, që tha: “Ama e pashë njëherë nënën pa burrë tha, në të sëmës se ngela pa babë vet”. Ndajeni mendjen vetë. Katër muaj se marr vesh se çfarë bëni ju. Do jemi prapë këtu pas 4 muaj, do thoni prapë ta shtyjmë edhe pak se nuk e dimë ende....

Kam bërë edhe një kërkesë nuk e di pse po vonon. U shqyrtua një ditë në Komision të Ligjeve për Kongresin e Lushnjës. Goja nuk ndjell gjë por fati e deshi, që ajo që unë deklarova në Komision të Ligjeve që ju i trembeshit nga 21 janari? Çfarë do bëjmë me 28 nëntorin? 28 nëntori është ditë zie. Do ta festojmë më? Kam bërë kërkesë që 21 janari të jetë festë zyrtare në nderim të 100 vjetorit të parlamentarizmit shqiptar dhe në respekt të ngjarjes së madhe historike të këtyre 107 vjetëve të Kongresit të Lushnjës. Nuk e di pse vonohen. Atë kërkesën e parë që kishim.

Gramoz Ruçi – Ku është kjo kërkesa?

Myslym Murrizi – Për 21 janarin e 2019 ja ku ndodhi, se ka zot lart.

Gramoz Ruçi – Është e përfshirë në program?

Myslym Murrizi – Nuk e shikoj në asnjë vend fare. Për koinçidencë dhe fatin e keq të fatit. Zoti Kryetar, 26 nëntori është dita e ngritjes së flamurit në Durrës. Ditën që ra tërmeti në Durrës, kanë rënë 52 veta në Durrës, ditën që kanë ngritur flamurin në Durrës. Ja, pra që qëlloni ajo që ju thashë unë në Komision të Ligjeve, që ne po t’i kapim datë më datë nuk ka datë historike që nuk ka familjen shqiptare që të kenë pasur fatkeqësi. Qytetarëve për gjithë respektin që kam prej kaq vitesh për ju, këtë nuk e mbyllni ju për 4 muaj. Do jemi prapë këtu. Do ta shtyni prapë ju.

Gramoz Ruçi – Duhet të them dy gjëra. E para, unë e mirëkuptoj atë që ngriti zonja Hajdari. Por duhet të kuptojmë edhe këtë tjetrën. Në qoftë se për një çast komisioni, kjo Konferenca e Kryetarëve nuk merr në konsideratë kërkesën, do të thotë që në datën 8 ne duhet që të mbledhemi për të shqyrtuar raportin, pra, në mënyrë të pashmangshme debati ose meraku

që ka zonja Hajdari që në këtë situatë duhet të diskutojmë për shkarkimin apo mos shkarkimin e Presidentit është evident. Në datën 8 mbaron afati i komisionit, kështu që ne duhet të mbledhemi të zhvillojmë debat. Duhet zhvilluar një debat i tillë në këtë kohë. Jo?

E dyta, ajo që tha zoti Balla, është që në historinë e komisioneve unë do mbaja pak a shumë të njëjtin vlerësim siç tha zoti Murrizi, që komisionet hetimore parlamentare nuk kanë qenë ndonjë histori suksesi në shumicën e rasteve, jo gjithmonë. Duhet të mos krijojmë asnjë precedent dhe precedenti është kjo rrugë, që kërkesa e Kushtetutës të saj sa herë ka kërkesa të tilla të komisioneve hetimore sipas Kushtetutës, parlamenti është i detyruar t'i miratojë ato. Kështu që nuk kemi pse të bëjmë target debati parlamentar këtë çështje, ndërkohë që të zbatojmë në mënyrë eksplicite nenin e Kushtetutës. Ta marrim në konsideratë kërkesën e saj. Komisioni le të vazhdojë punën, ndërkohë pas 4 muajsh edhe situata aktuale që kemi nuk do të jetë kjo. Mendoj do të jetë komplet ndryshe për këtë çështje. E mbyllim këtu, dakord!

Myslym Murrizi – Ulsi 4 muaj e ke kërkuar? Se shikoj firmën e Albanit. Nuk ke qenë në mbledhje?

Ulsi Manja – Prandaj është kërkuar 4 muaj, se ne e mbyllim sesionin. Dhjetorin ne e mbyllim në datën 20 dhe janari fillon të hënën e tretë, pra 20 janar. Gati dy muaj nga ky afat që është kërkuar, parlamenti nuk është i mbledhur.

Arben Ahmetaj – Kisha edhe unë një gjë. Unë kam bërë një propozim për linjën e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme. E kam dorëzuar dje në Kuvend të shkruar me relacion, besoj që nga ana procedurale duhet ta ndaj me ju në Konferencë të Kryetarëve apo jo? Që ta fusim sa më shpejt, sepse ka edhe një gjë teknike. Ministria e Financave kur solli buxhetin e ka planifikuar tek të ardhurat por nuk ka bërë asnjë propozim. Kjo plotëson edhe logjikën.

Gramoz Ruçi – Të futet në procedurë, të programohet dhe të diskutohet në datën 19 dhjetor!

Taulant Balla - Këtë kisha të parën, sepse është fundi i vitit dhe nuk është hera e parë që Kuvendi e bën këtë, por është një mundësi e mirë edhe në kontekstin e krijuar që do t'i jepet mundësi shqiptarëve që të rivlerësojnë pasuritë e tyre të paluajtshme edhe në kontekstin që shumë do të shkojnë të marrin, të aplikojnë edhe për sigurimin e banesave.

E dyta, që doja të flisja nuk kam gjë me deputetët që janë në grupet parlamentare. Do ishte mirë që kjo seancë të ishte një seance solemne, pra, nëse do bëhej një seancë me diskutime shumë të gjata që do të kërkonin orë, ndërkohë që në fund të fundit detyra e deputetëve është

që të jenë prezent në zonat përkatëse. Shoh që nuk është ndonjë numër i madh nga ana e opozitës të regjistruar për të folur, por mendoj që duke qenë që seanca fillon me një minutë heshtjeje, me një fjalë të Kryetarit të Kuvendit në emër të Kuvendit për t'u solidarizuar me familjet. Sa më të përmbledhura të ishin diskutimet, do ishte një mesazh që ne këtu do ta kalojmë bashkë. Edhe në fakt, dua të falënderoj edhe deputetët e opozitës si kryetar i grupit të shumicës dua t'i falënderoj për gjithë solidaritetin që kanë treguar edhe me prezencën e tyre së bashku me ne në territor, në zonat e prekura. Atë që nuk bëjnë dot me opozitën jo parlamentare të paktën këtu jemi bashkë.

Gramoz Ruçi - Dakord! Mbledhjen e deklaroj të mbyllur!

MBLEDHJA MBYLLET